



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 206/11 Prot.

Tiranë, më 16.02.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1157, datë 03.03.2008.

SHOQËRISË “HERKULES” SH.P.K  
Rr. Kavajës, Qendra e Biznesit “Gurten”, Zyra 311, Tiranë

Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE  
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA  
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “HERKULES” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1157, datë 03.03.2008, për mineralin Gëlqeror pllakor, në objektin “Kalivaç”, Bashkia Memaliaj.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.150, datë 11.01.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.206, Prot, datë 12.01.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1157, datë 03.03.2008, për mineralin Gëlqeror pllakor, në objektin “Kalivaç”, Bashkia Memaliaj pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar lidhur me miratimin e planit vjetor të punës për vitin 2021-2022 dhe ka ndërprerë aktivitetin minerar për më shumë se një vit, pa njoftuar strukturat përgjegjëse.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, shkronja “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1157, datë 03.03.2008, për mineralin Gëlqeror pllakor, në objektin “Kalivaç”, Bashkia Memaliaj që shoqëria Juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1157, datë 03.03.2008, për mineralin Gëlqeror pllakor, në objektin “Kalivaç”, Bashkia Memaliaj.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**  
**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ILIR BEJTJA**

